

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Fillim Skoro, kryetar, Tonka Berishaj dhe Have Haliti, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Përparim Zeka, procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarit B.B., për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.2, pika 2.1 lidhur me par.1 të KPRK dhe zbulimi i fshehtësisë zyrtare nga neni 433 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit B.B., av.S.M., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë,PKR.nr.310/16 të dt. 09.03.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.06.2018, morri këtë:

A K T G J Y K I M

I.Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit B.B., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë,PKR.nr.310/16 të dt. 09.03.2018, vërtetohet.

II. Në pjesën liruse aktgjykimi i përmendur nuk u shqyrtua sepse nuk kishte ankesë.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë,PKR.nr.310/16 të dt.09.03.2018, i akuzuari B.B. është liruar nga akuza për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoriteti zyrtar nga neni 422 par.2, pika 2.1 lidhur me par.1 të KPRK, pasi që nuk është provuar që i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe për këtë veprë penale ka vendosur që shpenzimet gjyqësore të bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate, ndërsa e ka shpallur fajtor për veprën penale zbulimi i fshehtësisë zyrtare nga neni 433 par.1 të KPRK-së dhe të akuzuarin e ka dënuar me dënim me kusht në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj burgim, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 2(dy) viteve pas që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nuk kryen veprë tjetër penale.

I akuzuari është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 100(njëqind) €, në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se 3(tre) muaj pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

Mbrojtësi i të akuzuarit B.B., av. S.M., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal me propozim që në pajtim me nenin 398 par.1, nën par.1.1 dhe nenit 402, par.2 të KPPK-së, ta anulojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë me aktvendim, dhe ta refuzojë aktakuzën, për shkak se ekzistojnë rrethanat nga neni 358 par.1, nën par. 1.3 dhe të mbrojturin e tij ta liroj nga akuza.

Prokurori i Apelit në parashtresën PPA/I.nr.167/18 të dt. 23.04.2018 ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësi të akuzuarit B.B., av. S.M., kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Konform nenit 390 par.1 të KPPK, seanca e kolegjit është mbajtur në mungesë të palëve sepse kemi të bëjmë me aktgjykim me të cilin të akuzuarit i është shqiptuar dënim me kushte, andaj nuk është e nevojshme që palët të njoftohen për seancën e kolegjit, kurse i akuzuari dhe mbrojtësi i tij nuk kanë kërkuar që të njoftohen për seancën e kolegjit.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike si dhe aktgjykimin e ankimuar në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë thekson se aktgjykimi i shkallës së parë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 1.8 dhe 1.12 të KPPK. Pretendon se gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e bazon në deklaratën e dëshmitarit B.H., i cili situatën e ka paraqitur tërësisht të shtrembëruar sepse ka pasur konflikt të interesit pasi që në kohën kur i akuzuari ka dhënë intervistë në KTV është anuluar konkursi për pozitën e Drejtorit në Departamentin për prodhimin e dokumenteve në Agjencinë e Regjistrimit Civil të Kosovës, në cilën pozitë është emëruar dëshmitari pas suspendimit të akuzuarit nga puna. Po ashtu pretendon se aktgjykimi i ankimuar është në kundërshtim me dispozitën e nenit 370 par. 6 dhe 7 të KPPK, për shkak se gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur që në arsyetimin e aktgjykimit të paraqes në mënyrë të qartë provat në të cilat është bazuar me rastin e shpalljes fajtor të akuzuarit, por tërë aktgjykimin e bazon në deklaratën e dëshmitarit B.H. dhe vendimin nr. 653/2013, se kinse në këtë vendim ka gjetur elemente të shkeljes së fshehtësisë zyrtare. Pretendon se gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur që të paraqes qartë dhe në mënyrë të plotë

se cilat fakte dhe për çfarë arsye e konsideron deklaratën e dëshmitarit B.H. si të vërtetë dhe të besueshme pa vlerësuar kundërthëniet në deklaratat e tij në fazat e ndryshme të procedurës penale kur dihet se ai kishte interes personal që i akuzuari të shpallet fajtor, por nuk ka dhënë as arsye pse nuk janë miratuar propozimet e mbrojtjes për tu shqyrtuar si provë CD-të e lajmeve në RTK dhe KTV ku janë paraqitur të gjitha ato që janë thënë nga i akuzuari në emisionin ‘‘Interaktiv’’ dhe dëshmojnë se veprimet e të akuzuarit nuk kanë të bëjnë me zbulimin e fshehtësisë zyrtare.

Gjykata e Apelit gjen se nuk qëndrojnë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduar, as shkelje tjera për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate dispozitivi i aktgjykimit, si dhe aktgjykimi i ankimuar për pjesën dënuese (dispozitivi nën II), është i qartë dhe konkret, përmban arsye të duhura mbi të gjitha faktet vendimtare, të kësaj çështje juridiko-penale. Kështu, përshkrimi i dhënë në dispozitiv është i plotë dhe i kuptueshëm, me asgjë të njëjtin nuk e bënë dubioz. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, janë dhënë arsyet e duhura faktike dhe juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë.

Gjykata e shkallës së parë, ka bërë vlerësimin dhe analizën e provave të administruara, gjatë shqyrtimit gjyqësor në pajtim me dispozitën e nenit 361 të KPPK lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta. Ajo ka bërë analizën e thuktë të të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe, lidhur me to, ka paraqitur përfundimet e veta, të cilat, si të drejta, i pranon edhe kjo Gjykatë. Ka dhënë arsye të mjaftueshme me rastin e zgjedhjes së çështjes juridike, veçanërisht me rastin e ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit, me ç ‘rast edhe mbrojtja e të akuzuarit ka qenë objekt i vlerësimit si çdo provë tjetër.

Pra, aktgjykimi i ankimuar nuk mbështetet në prova të papranueshme-deklaratën e dëshmitarit B.H., si pretendohet me ankesë dhe fakti se ky dëshmitarë ka marr pjesë në konkurs (dhe është pranuar) për pozitën e drejtorit në të cilën më pare ka qenë i sistemuar i akuzuari dhe anulimi i vendimit për zgjedhjen e tij sipas kundërshtimit të akuzuarit, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, nuk paraqesin pengesë për dëgjimin e tij si dëshmitarë pasi që nuk hynë në kategorinë e personave të liruar nga detyra për tu dëgjua si dëshmitarë parashikuar me nenin 127 të KPPK, ndërsa sipas nenit 125 par. 1 të KPPK organi që zbaton procedurën penale, në çdo faze të saj, para marrjes në pyetje dëshmitarit, ka për obligim që dëshmitarit t’ia lexoj paralajmërimin që parashikon kjo dispozitë e në mes tjerash edhe detyrimi që të tregon të vërtetën dhe nëse nuk tregon të vërtetën mund të ndiqet penalisht sipas nenit 390 ose 391 të KPPK. Nga shikimi i shkresave të lëndës rezulton se dëshmitari është njoftua dhe udhëzua në pajtim me dispozitat e KPPK, ndërsa nga shikimi i aktgjykimit të ankimuar rezulton se gjykata e shkallës së parë deklaratën e këtij dëshmitari dhe të dëshmitarit B.C., i vlerëson si dëshmi rrethanore, pasi që gjendja faktike është vërtetuar me prova materiale që si të drejtë e aprovon edhe kjo Gjykatë.

Prandaj, qasja ndaj fakteve vendimtare-relevante është e drejtë dhe e ligjshme, asnjë fakt nuk ka ngelur dubioz ose i pavërtetuar. Kështu konkludimet të cilat i ka nxjerrë gjykata e shkallës së

parë janë të drejta, sepse kanë mbështetje në provat e administruara dhe jo vetëm që janë drejtë të vërtetuara, por edhe në mënyrë të drejtë dhe të plotë janë të arsyetuara.

Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit pretendohet se faktet vendimtare të kësaj çështjeje nuk janë vërtetuar drejtë. Kështu nuk është shqyrtuar në mënyrë meritore dosja e tenderit e siguruar nga MPB në cilën janë bërë publike të gjitha ato elemente të cilat i akuzuari i ka trajtuar në emisionin ‘‘Interaktiv’’ në KTV. Po ashtu thekson se i akuzuari në këtë emision i ka denoncuar publikisht shkeljet të cilat janë bërë nga dëshmitari B.H. në prodhimin e pasaportave, për shkak të kualitetit të dobët të pasaportave biometrike, makinerisë për prodhimin e tyre e cila nuk ka qenë në nivelin e kërkuar si dhe çipin e sigurisë të cilat kanë qenë të kualitetit shumë më të dobët krahasuar me pasaportat e ofruara nga kompania Austriake, e cila i ka prodhuar pasaportat para shpalljes së tenderit. Po ashtu pretendon se asnjë fakt që ka përmendur i mbrojturi i tij nuk paraqet element të sigurisë të përcaktuar me vendimin 284/13 të dt. 12.06.2013 e as me ligjet dhe aktet nënligjore dhe vetëm fakti se në emision përmendet çipi dhe sqarohet se në çip ruhen të dhënat, nuk paraqet sekret sipas Ligjit dhe vendimit përkatës aq më parë kur sistemi operativ i çipit në dosjen e tenderit të publikuar në faqen e MPB përmendet më shumë se 40 herë. Pastaj në këtë tender përmendet edhe qepja e pasaportave, lidhja e tyre dhe peri për lidhje, ndërsa laminimi është rregulluar me Udhëzim administrativ 02/2013.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate edhe pretendimet e mësipërme ankimore nuk qëndrojnë nga këto arsye:

Përkitazi me pjesën gjyquese të aktgjykimit të ankimur nga shkresat e lëndës rezulton si jo kontestues fakti se i akuzuari në kohën inkriminuse e kishte pozitën e personit zyrtar pasi që mbante pozitën e udhëheqësit të divizionit për prodhimin e dokumenteve në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës e as fakti se i akuzuari me dt. 04.02.2016 ka dhënë intervistë në emisionin ‘‘Interaktiv’’ në KTV dhe në këtë intervistë duke pretenduar se janë bërë shkelje në prodhimin e pasaportave ka përmendur dhe diskutuar për specifikat teknike të prodhimit të pasaportave si vendosjen e çipit, lidhjen dhe laminimin e tyre. Këto fakte gjykata e shkallës së parë i ka vërtetuar nga mbrojtja e të akuzuarit, dëshmia e dëshmitarve B.H. dhe B.C., por edhe nga provat materiale të bashkangjitura shkresave të lëndës, pikrisht transkripti i intervistës së dhënë nga i akuzuari në emisionin ‘‘Interaktiv’’ në KTV dhe CD e incizimit të intervistës.

Kontestues është fakti se specifikat teknike për prodhimin e pasaportave të përmendura nga i akuzuari në emisionin në fjalë (vendosja e çipit, lidhja dhe laminimi) a paraqesin fshehtësi zyrtare, si pretendon aktakuza apo këto të dhëna nuk janë sekrete pasi që tenderi për prodhimin e këtyre dokumenteve ishte publik dhe përmbante të gjitha specifikat teknike të përmendura nga i

akuzuari në intervist duke përfshirë çipin, qepjen dhe mënyrën e laminimit, siç pretendon mbrojtësi i të akuzuarit me ankesë.

Nga mbrojtja e të akuzuarit dhe transkripti i intervistës, por edhe nga shikimi i CD të emisionit “Interaktiv” në KTV, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se i akuzuari në këtë intervistë ka përmendur-diskutuar për elementet e sigurisë në pasaporta, përkatësisht vendosjen e çipit, lidhjen, qepjen dhe laminimin e pasaportave, të dhëna këto që sipas vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm të MPB të Republikës së Kosovës, Nr.653/2013, të dt. 15.08.2013, janë klasifikuar si sekrete. Pra, ashtu si drejtë ka gjetur edhe gjykata e shkallës së parë, me vendimin e përmendur (Nr.653/2013, të dt. 15.08.2013), është miratuar lista e informacioneve të prodhuara nga MPB si dhe niveli i klasifikimit të këtyre informacioneve dhe kjo listë i është bashkangjitur këtij vendimi me të cilin obligohen autoritetet përgjegjëse për zbatimin e tij prej momentit të nënshkrimit nga Sekretari i Përgjithshëm, kur edhe ka hy në fuqi. Nga shikimi i këtij vendimi, rezulton se përkitazi me Agjencinë e Regjistrimit Civil në pikën 1 të listës janë paraqitur elementet e sigurisë për dokumentet civile dhe dokumentet tjera që prodhohen në ARC, të klasifikuara si sekrete, ndërsa në faqen 4 të listës në numrin 46 është paraqitur se pozita e Udhëheqësit të divizionit të prodhimit, të cilën në atë kohë e mbante i akuzuari, nivelin e klasifikimit e ka pasur “sekret”. Me këtë rast gjykata e shkallës së parë duke ju referua Ligjit nr. 03/i-178 për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë, pikërisht nenit 7 par. 4 të këtij Ligji, jep edhe arsye të hollësishme për bazën ligjore dhe kompetencën e Sekretarit të Përgjithshëm të MPB për marrjen e vendimit në fjalë. Nga arsyet e lartcekura rezulton se gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike e mbështet në provat materiale dhe vetëm fakti se në tenderin e publikuar në faqen zyrtare të MPB për prodhimin e pasaportave përmenden specifikat teknike të elementeve të sigurisë të pasaportave (por jo vendi ku do të vendoset çipi), nuk e liron të akuzuarin nga obligimi për tu përmbajtur vendimit të përmendur të Sekretarit të Përgjithshëm të MPB, ndërsa lidhur me parregullsitë në prodhimin e pasaportave, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, i akuzuari ka pasur mundësi të veproi në mënyra tjera pasi që e ka ditur se pozita e tij është e klasifikuar si “sekret”.

Nga arsyet e lartcekura dhe arsyet e dhëna më gjerësisht në aktgjykimin e kundërshtuar, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike në këtë çështje penale, nga e cila rezulton se në veprimet e të akuzuarit B.B. përmbahen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale-zbulimi i fshehtësisë zyrtare nga neni 433 par. 1 të KPRK, nga se i akuzuari pa autorizim ka zbuluar fshehtësinë zyrtare duke diskutuar në emisionin “Interaktiv”, për procesin e punës së prodhimit të dokumenteve dhe shenjave të sigurisë së pasaportave siç janë vendosja e çipit (faqja ku vendoset), qepja, dhe mënyra e laminimit, të cilat procedura sipas vendimit 653 /2013 të dt. 01.10.2013, janë klasifikuar sekrete.

Vendimi për dënim.

Sa i përket vendimit për dënim mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë thekson se dënimi i shqiptuar të akuzuarit , edhe pse me kusht, ka qenë i pavend për shkak se me asnjë provë nuk është vërtetuar

se i akuzuari ka kryer veprën penale dhe shqiptimi i dënimit me burgim me kusht prej 6 muajve është i lartë për arsye se i njëjti do ta humbë të drejtë për të punuar si drejtor në DPD.

Duke vlerësuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin për dënimin për të akuzuarin B.B., kjo Gjykatë i pranon të gjitha rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë, duke mos gjetur ndonjë rrethanë tjetër lehtësuese e cila kishte me ndikua në dënimin e shqiptuar, ndërsa, duke marrë parasysh intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor, vlerëson se dënimi i shqiptuar është në funksion të preventivës së përgjithshme, posaçërisht asaj të posaçme dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41 të KPK-së. Për një dënim më të butë, siç pretendon mbrojtja, nuk janë plotësuar kushtet ligjore, aq më parë kur me ankesa nuk theksohen rrethana të tilla që do të arsyetonin një dënim më të butë.

Aktgjykimin lirues nuk u shqyrtua sepse nuk ishte ankimuar.

Nga çka u tha më lartë, në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR 177/2018 datë 14 qershor 2018

Procesmbajtës,

Përparim Zeka

Anëtarët e kolegjit,

Tonka Berishaj

Have Haliti

Kryetari i kolegjit,

Fillim Skoro